



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-033
Prishtinë, më 23 shtator 2008, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 23 SHTATOR 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Slllobodan Petroviq, ndërsa mungoi (me arsye) Nexhat Daci.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjaj dhe Lutfi Haziri, ndërsa munguan Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Zylfi Merxha dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI: Rinor Bekaj dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryetari propozoi që nën pikën - Të ndryshme të shqyrtohet mundësia e procedimit të ligjeve të pashpallura me procedurë të shpejtuar.

Lutfi Haziri propozoi që kërkesa e Grupit Parlamentar për ndërrimin e anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa të radhitet për seancën e radhës.

Naim Maloku propozoi që kërkesa e Ministrisë së Forcës së Sigurisë për ndarjen e mjeteve të radhitet për seancën e radhës.

Në vazhdim Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 shtator 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 shtator 2008

Sabri Hamiti pati vërejtje në tanskript, në faqen e 6-të, pika 2.4 që ishte evidencuar gabimisht "Projektligji për ndarjen e deklaratave", kurse duhet të jetë: " Projektligji për ndarjen e dekoratave".

Xhavit Haliti kontestoi vendimin në procesverbal lidhur me caktimin e orarit të punës për Administratën e Kuvendit, të cilin e kishte kundërshtuar edhe në mbledhjen e mëparshme.

Kryetari tha se vendimi për caktimin e orarit të punës për Administratën e Kuvendit mbetet në fuqi deri sa kjo çështje të rregullohet me ligj.

Kryesia miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 shtator 2008.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më **25 shtator 2008**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 18 shtator 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët, dhe
6. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

Lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Forcës së Sigurisë për ndarjen e mjeteve që të radhitet për seancën e radhës, Kryesia nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Nëse Komisioni për Buxhet dhe Financa e përgatit raportin me rekomandime për Kuvend, kërkesa e Ministrisë së Forcës së Sigurisë radhitet për seancën plenare më 25.09.2008.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për caktimin e datës së regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Kryesia konstatoi se duhet bërë konsultime shtesë me Qeverinë e Kosovës para se ky propozim të radhitet për shqyrtim në seancë plenare.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesia vendosi që Raporti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit.

3.3 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Propozimvendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave

Kryesia shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe lidhur me të nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Kosovës që t'i plotësojë biografitë e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Bordit të Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave me dëshmitë përkatëse për përgatitjen e tyre, si dhe dëshmitë për përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe t'ia dërgojë Kuvendit për shqyrtim.

3.4 Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë

Raporti i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri u shty për mbledhjen e ardhshme.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Presidentit për ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit aktual lidhur me pensionimin e profesorëve ordinarë dhe inordinarë në Universitetin e Prishtinës

Kryesia shqyrtoi kërkesën e Presidentit dhe lidhur me të nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Nisma e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me moshën e pensionimit të profesorëve të Universitetit të Prishtinës i dërgohet Qeverisë së Kosovës që ta shqyrtojë me rastin e hartimit të legjislacionit për këtë fushë.

3.6 Shqyrtimi i propozimit për plotësimin e Projektbuxhetit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2009

Sekretari i Kuvendit arsyetoi propozimin për Projektbuxhetin e Kuvendit për vitin 2009 në shumën prej 815.000€, sipas specifikimit për kodet buxhetore.

Xhavi Haliti propozoi që Projektbuxheti për vitin 2009, për të funksionalizuar punët e Kuvendit, duhet të plotësohet, si vijon:

1. Për 120 deputetët e Kuvendit të Kosovës
 - T'ju lejohet një zyrë pune për kontakt me elektoratin në një shumë qiraje deri 300 €.
 - Një asistent deri 200 €.
 - Një makinë deri 6000 €, dhe të lirohet nga dogana - për mandatin. (nuk ka të drejtë ta shesë pa e paguar doganën).
 - 100 € benzinë në muaj.
 - Privilegjet e mëhershme të mbesin.
2. Buxheti i Kosovës të shqyrtohet nga të gjitha komisionet e Kuvendit dhe vërejtjet të kenë fuqinë e njëjtë me Komisionin për Buxhet dhe Financa.
3. Buxheti i Kuvendit të menaxhohet drejtpërsëdrejti nga Kuvendi, respektivisht nga Kryesia e Kuvendit, ose ndonjë variant tjetër i përshtatshëm.
4. Të gjitha komisioneve shtesa të barabarta.
Të ketë një fond rezervë për ndërhyrje. Fondi i kërkuar për lobim mos të quhet ashtu. Ai të kërkohet në shumën prej 1 500 000 € dhe të jetë Fondi për diplomaci parlamentare dhe ndërtimin e raporteve ndërparlamentare me vende të ndryshme.
5. Për Kryesinë e Kuvendit të Kosovës 1 000 000 €.
6. Për këshilltarët e Kryesisë, çdo anëtar i Kryesisë të ketë këshilltar politik – legjislativ. Pagat të jenë të barabarta me pagat e këshilltarëve të Kryetarit.
7. Për shërbime konsulente 500 000 €.
8. Të rregullohet çështja e mëditjeve sipas hierarkisë në parlament dhe detyrave në administratë.

Kryesia miratoi propozimet e cekura më lart dhe vendosi që ato t'ia dërgojë Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për t'i përfshirë në Buxhetin e Kuvendit për vitin 2009.

3.7 Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit

Kryesia shqyrtoi kërkesat për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit dhe vendosi, si vijon: deputetes Radmila Vujoviq i kompensohen mëditjet gjatë qëndrimit të saj në Norvegji prej 15 deri më 18 shtator 2008; deputetit Armend Zemaj i kompensohen mëditjet e udhëtimit në Estoni prej 9 deri më 13 shtator 2008, dhe sekretarit të Kuvendit i lejohet udhëtimi zyrtar në Parlamentin e Sllovenisë, prej 28 deri më 30 shtator 2008 dhe i kompensohen shpenzimet e udhëtimit dhe të mëditjeve.

4. Të ndryshme:

4.1 Kryesia u njoftua me shkresën e deputetit Dragisha Miriq për kalimin e tij në Grupin Parlamentar të SLS-së dhe me shkresën e deputetit Numan Baliq për dalje nga Grupi Parlamentar i AAK-së.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale